

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
FAKULTETI I DREJTËSIË
PROGRAMI STUDIMOR „Sudimet e sigurisë”



Tezë Magjistrature

Tema: „Studimi mbi armët e zjarrit”

Mentori:

Prof.dr Besa Arifi

Kandidati:

Rexhep Emini

Tetovë, 2018

Përbajtja

Hyrje

Fillimisht në këtë temë do të trajtohen njohuri të përgjithshme mbi balistikën dhe Studimin e armëve të zjarrit në përgjithsi. Kjo lëndë konsiston në analizën e historikut të armëve të zjarrit qysh nga fillimi i prodhimit të tyre deri në ditët e sodit.

Gjithashtu do të analizohet edhe formimi i tyre, dinamika dhe ecuria e punës në zhvillimin e tyre, llojet, përdorimi i armëve me dimensione të ndryshme duke filluar nga ato më të shkurtrat deri te armët më të gjata si dhe balistika e tyre, prej te më të lehtat deri te ato më të rëndat.

Ku në grupin e armëve më të shkurtra bëjnë pjesë disa prej tyre me dimensione të tytës deri 28cm si p.sh: pistoletat, revolveri, arma stilograf, armë të shkurtra për një qitje me ndezje qendrore, armë të punuara në mënyrë artizanale etj, ndërsa në grupin e armëve më të gjata bëjnë pjesë ato armë të cilat tyta e tyre e kalon gjatësin deri 60cm si p.sh pushkët e gjahut (saçmare), gjysëm automatike, automatike ushtarake, pushkët karabinat etj.

Në grupin e armëve më të lehta bëjnë pjesë: pistoletat, pushkat e llojeve të ndryshme, ndërsa në grupin e armëve të rënda bëjnë pjesë: bomba e dorës, minat e montuara, minahedhësit e dorës, tanket etj.

Do të pëpiqem të jap një pasqyrim shkencor duke qenë i kujdesshem për të mos i tejkalluar kornizat e objektivitetit.

I. Kuptimi dhe ndarja e balistikës

1.1 Kuptimi i balistikës

Fjala balistikë rrjedh nga Greqishtja („ballo” që do të thotë „të hedhësh”). Në shekullin e kaluar „baliste” quheshin veglat që përdorehin për gjuajtjen e gurrëve. Balistika është shkencë mbi lëvizjen e trupave të hedhur në përgjithësi (lëvizjen e predhës në tytë dhe jashtë saj). Balistika kriminalistike studion metodat dhe mjetet teknike – shkencore, për zbulimin, fiksimin, ekzaminimin e gjurmëve të lënë nga armët e zjarrit, nga municioni që është përdorur prej tyre.

Në fillim të shekullit XX filloj fabrikimi i armëve të zjarrit, tytat e të cilave mbanin vjaska. Roli i tyre ishte për tu dhenë predhave shpejtësi. Mbi këto baza filluan studime të thelluara për identifikimin e armëve të zjarrit në bazë të pradhavës. Balistika kriminalistike studion metodat e mjetet teknike shkencore për zbulimin, fiksimit dhe ekzaminimin e gjurmëve të lënë nga armët e zjarrit, nga municionet që përdoren prej tyre, për identifikimin e armës së zjarrit në bazë të gëzhgjës së predhës, si dhe metodat e mjetet për përcaktimin e gjendjes teknike të armës së zjarrit dhe të fenomeneve të qitjes me qëllim që të zgjidhin probleme që lindin në hetimin dhe gjykimin e çështjes penale.

Balistika kriminalistike për studimin e këtyre problemeve mbështet në shkencat teknike, ushtarake, në metodat gjithnjë në zhvillim të shkeqave të kimisë, fizikës (siç janë spektrofotografia, stereofotografia, mikrografia, makrofotografia krahasuese, ekzaminimi mikroskopik krahasues), analizat kimike, mikrokimie, ekzaminimin me rreze të padukshme (infra të kuqe, ultravjollcë, rrezet roentgen të njohura si rrezet X) dhe së fundmi në të dhënat e traseologjisë si dhe në mjeksinë ligjore.

Problemet që zgjidhen me anë të balistikës kriminalistike lidhen me gjendjen e armës së zjarrit – prove material; me identifikimin grupor dhe individual të armës së zjarrit, të gëzhgjës, të predhës, të municioneve, të saçmave; me rrethanat e qitjes (koha, largësia, shpejtësia, drejtimi, vendi i ndodhjes së qitësit dhe të viktimës, vrima e hyrjes dhe e daljes në trupin e viktimës ose në sendet e vendit të ngjarjes, numri i qitjeve dhe rradha e tyre).

1.2 Ndarja e balistikës

Balistika ndahet në dy degë: në balistikë të brendëshme, e cila studion lëvizjen e predhës brenda tytes së armës së shtyrë nga trysnia e gazrave të barutit dhe në balistikë të jashtme e cila studion lëvizjen e predhës pasi të dale nga gryka e tytës, kur ndaj asaj predhe ushtron ndikim graviteti i tokës dhe rezistenca e ajrit. Në kuadër të balistikës është edhe një discipline tjetër shkencore – balistika kriminalistike gjyqësore, e cila në mënyrë të gjithanshme studion çështjet e armëve të zjarrit që kanë lidhshmëri me kriminalitetin.

Në përgjithësi zhvillimi historic i balistikës së brendëshme është ngushtë i lidhur me zhvillimin shkencës së fizikës, matematikës dhe shkencave teknike. Njëra ndër periudhat më të rëndësishme të zhvillimit të balistikës së brendëshme është zhvillimi i barutit të koloidnitroceluloz dhe nitroglicerit.

Kinezët e kkanë njohur prodhimin e barutit disa shekuj para erës sonë. Në shekullin VII p.e.s., bizanitinët e kanë përdorur të ashtuquajturin zjarrë Grek (përzierjen e salnitër, sulfurin, kaliforniumi, katranit dhe gëlqeres) si mjet shumë efikas në luftërat detare. Në fillim të shekullit XIII morgue Gjerman Beholt Shark zbuloi se përzierja e sulfurit, salnitër dhe karbonit mund të përdoret si shtytës (fuqi motorike) për ngrohjen e gjoleve të rrënda të gurrit gjatë pushimit të fortifikatave mesjetare, ashtu që gjylet e para të mbushura me barrut të zi janë përdorur në betejën e Krasit, më 1346. Që prej atëherë e pesë shekuj në vazhdim pushkët e gjylet ishin të mbushura me barut të zi.

1.2.1. Balistika e brendëshme

Balistika e brendëshme, pëshkakë të shpjegimit jo të mjaftueshëm të ligjshmërive të djegjes tek mbushjet me barut si dhe problem tjera që kanë të bëjnë me lëvizjen e projektilit me tytë, deri në fillim të shekullit XIX, mbetet relativisht e pa zhvilluar.

Baza e balistikës së brendëshme i dha francezi Pioneer, i cili në vitin 1839 përcaktoi ligjmërinë e djegjes së barutit sipas shtresave paralele të cilat vlejné për barutin joyous. Mjetet e para të shtypjes maksimale në tytën e armës së zjarrit me ndihmën e kërcenit, në vitin 1860, i bëri A. Nobel. Katër vite më vonë Resell publikon barazimin e parë themelorë të tijë të balistikës së brendëshme.

1.2.2. Balistika e jashtme

Balistika e jashtme studion lëvizjen e predhës prej daljes nga tyta deri te pika e fundit e rrugëtimit, apo deri te goditja e caktuar ose zbërthimit të tijë në ajër. Si discipline shkencore paraqet një pjesë të aplikimit të mekanikës racionale dhe bazohet në ligjet e dinamikës. Balistika e jashtme mbështet edhe aerodinamikën e cila e mundëson shpjegimin e fuqisë që ndikon në predhë gjatë lëvizjes nëpër ajër, aerologjinë dhe meteorologjinë me rastin e analizimit të ndryshimit të parametrave ajrorë të ambientit si dhe shkencave fundamentale: matematika, termodinamika si dhe mekanizmi i fluidit.

Arritjet më të mëdha në zgjedhjet e problemeve të balistikës së jashtme janë bërë me fillimin e përdorimit të mainave llogaritëse elektronike si dhe mekanizmave të tjerë elektronik për matje në balistikë. Përveç ndarjes së përmesur të balistikës, balistika si shkencë mbi lëvizjen e projektilit mund të ndahet edhe në tri pjesë, të cilat në pjesë të pavarur studiojnë lëvizjen e projektilit në pjesët e caktuara të rrugëtimit të vet. Kështu, derisa balistika e brendëshme studion lëvizjen e projektilit Brenda tytës, balistika e jashtme studion çështjet që kanë të bëjnë me lëvizjen e projektilit pas daljes nga gryka e tytës, lëvizjen e tijë nëpër hapësirën ajrore deri në shpejtësinë e fundit që mund të arrijë ose deri në goditjen e shenjës.

1.2.3. Balistika terminale

Si pjesë e tretë e kësaj discipline shkencore paraqitet balistika terminale apo balistika e caktuar, e cila studion efektin e projektilit në shenjën e qëlluar. Kështu balistika terminale studion efektin e projektilit në cak. Efekti në cak është i kushtëzuar në masën dhe shpejtësinë, edhe pse nuk mund të lihen pas dore faktorët si: forma e projektilit, lloji i caktuar, lokacioni i goditjes etj.

II. Klasifikimi i armëve të zjarrit

Armët e zjarrit mund të klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme. Në bazë të mekanizmit të punës, ato ndahen në të respektuara, të cilat për ndezjen e çdo predhe, duhet të ndërmeren operacione mekanike, me të cilat predha futet në tytë, ndizet dhe e hedh jashtë gëzhgojnë e ndezur; gjysmëautomatike, të cilat mjafton që vetëm predha e parë të futet në tytë e që më vonë në mënyrë suksesive të bëhet ndezja e të gjitha predhave dhe automatike, të cilat pas futjes së predhës së parë në tytë ndezja e të gjitha predhave të mbetura bëhet në mënyrë automatike.

Sipas gjatësisë së tytës, armët mund të ndahen në armë me tytë të gjatë dhe armë me tytë të shkurtër. Në armë me tytë të gjatë bëjnë pjesë të gjithë llëjet e pushkëve, kurse me armë me tytë të shkurtër bëjnë pjesë revolverat dhe pistoletat. Pushka bakëkëhore ka një histori mjaftë të gjatë të zhvillimit.

Armët më të vjetra të ngjashme me pushkët paraqiten qysh në shekullin XIV. Për dallim nga armët e zjarrit „armët e ftohta” janë mjete të përgaditura posaçërisht për qëllime luftarake, për të shkaktuar dëmtime trupore ose vdekjen. Quhen armë „armët e zjarrit” të çdo lloji kalibri (armët luftarake e sportive, gjuetie e special dhe të prodhuara e të përshtatura në mënyrë artizanale) municionet e tyre, bombat e minat, si dhe armët e ftohta (si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjetet e tjera të përgaditura e të destinuara për sulme ose për vet mbrojtje.

Disiplina shkencore e teknikës kriminalistike- balistikë, në studimin dhe ekzaminimin e gjurmëve të ndryshme të armëve të zjarrit, përqendrohet tërësisht në çfarëdo lloji të tyre me qëllim të përcaktimit të vend qëndrimit të qitësit, kohës së qitjes, largësisë së qitjes dhe shumë fakteve të tjerë që i përkasin fushës së balistikës.

Përcaktimi i gjurmës së caktuar dhe rolit të sajë në tërësinë e ndriçimit të krimit të kryer me armë zjarri nuk mund të bëhet vetëm me ekzaminimin dhe shpjegimin e një nga gjurmët e tilla por në tërësi dhe lidhshmëri me gjurmët e tjera që janë në çfarëdo lidhjeje me përdorimin e armës së zjarrit në krimin e caktuar p.sh në vrasje. Mirpo me këtë rast duhet veçuar gjurmët e të shtënave në gëzhoje, predhës, ose përcaktimin e kohës kur është qitur nga armët.

Sa i përket rikonstruimit të rrugës së predhës, që në fillim duhet theksuar: në këtë rrugë, me rastin e daljes nga tyta e armës së zjarrit, predha hasë në pengesa të ndryshme në të cilat os edepërton ose i gërvishtën, ose ndalet në vet pengesën. Këto gjurmë të predhës mund të dhërbejnë për rikonstruimin e rrugës së predhës kontenstuese. Në bazë të pamjes së demtimit, duke i lidhur dy apo më shumë demtime fitohet rruga e predhës, ku bëhen koreksionet në varësi nga largësia e qitjes, pengesa në të cilat ka kaluar predha, si dhe këndit elevacional.

Në praktikë shpeshherë nga gjykata shtrohet pyetja – pozicioni i personit që ka kryer të shtëna kritike dhe pozicioni i të demtuarit, përcaktohet në bazë të gjurmëve materiale nga e shtëna në vendin e ngjarjes, proceverbali i obduksionit (nëse bëhet fjalë për vrasje), kqyrjen e konfiguracionit të terrenit duke marrë në konsiderim llojit e armës së zjarrit të përdorur dhe të dhënave nga lënda hetimore.

Çështja e përcaktimit të vjetërsisë së qitjes është e lidhur pothuajse me çdo vepër penale të kryer me armë zjarri. Pyetja e zakonshme, ecila në këto raste shtohet para teknikës kriminalistike, është përcaktimi se kur është shtënë nga kjo armë që bën pjesë në vjetërinë absolute të qitjes. Sikur edhe gjithë më parë me përcaktimin e vjetërsisë është e domosdoshme të plotësohet kushti i ekzistimit të parametrin i cili ndërhoet me kohë.

Me rastin e qitjes nga arma e zjarrit gjurmët e vetme të cilat mbesin mbas shtënës janë gjurmët e të djegurave të barutit në tytën e armës. Kjo do të thotë që ndryshimet e vetme në të djegurat e barutit mund të japin të dhëna mbi kohën e të shtënave. Këto ndryshime i kanë studiuar shumë autorë, me ç'rast është ardhur deri tek njohurit e caktuara të cilat mundësojnë përcaktimin e përafërt të kohës, të kaluar pas qitjes, por në kufijë relativisht të ngushtë.

Çë është e verteta, në të djegurat e barutit në tytën e armës, shkaktohen ndryshime të cilat manifestohen, si ne vet të djegurat ashtu edhe në paraqitjen e kristaleve të caktuara. Si ndryshim i fundit, në këtë rast paraqitet ndryshku. Të gjitha këto ndryshime ndodhin në intervalin kohor Brenda më së shumti shtatë ditëve e pas paraqitje së ndryshkut, praktikisht azgjë nuk mund të thuhet për vjetërësin e qitjeve. Theksohet se paraqitja e ndryshkut shpeshherë mund të inicohet edhe në mënyrë tjetër, siç është p.sh qëndrimi i armës në ujë.

Rëndësi të vacant ka puna e drejtë me armë tek e cila kërkohet vjetërsia e të shtënave, në këto raste çfardo pastrami i tytës ose, të shtënat e sërishme, tërësisht azgjësojnë gjurmët e mëparshme. Prandaj mënyra më e mire e sigurimit të gjurmëve të qitjeve është që arma të bartet menjëherë në laborator, ku në mënyrë të përshtatshme bëhet fisimi i gjurmëve të të djegura të barutit në tytën e armës.

Sa i përket gjurmëve të predhës në depërtimin në tesha dhe në lëkurë duhet pasur prasysh këto rrethana: me daljen e predhës nga tyta e cilësdo armë të zjarrit (p.sh pistoleta, revolveri, pushka, automatiku, mitralozi etj.), në sipërfaqen e predhës, përveç të djegurave të barutit ndodhet edhe sasia tejet e vogël (një pjesë e millionët e gramit) antimony dhe barium e diçka më shumë plumb. Antimony dhe bariumi bëjnë pjesë në përbërje nga e cila bëhet mbushje e pare për kapisllën e fishekut, kurse plumbi është nga vetë predha.

Me të kaluarit e predhës nëpër ajër, sasia e të djegurave të barutit si dhe antimonite, bariumit dhe plumbit zvoglohen duke marrë parasyshtë rrotullimin e predhës nëpër ajër, që ndeshet me molekulat e ajrit. Kjo sasi zvoglohet me progression gjeometrik, por asnjëher deri në zero. Çë është e vërteta, në sipërfaqen e predhës dhe pas kalimit të qindra metrave nëpër shtresave të ajrit, gjithnjë ekziston sasia e vogël e antimonite, bariumit dhe plumbit.

Pasi që predha kalon nëpër pengesën e pare, p.sh setren e victims sipërfaqja e predhës fshihet në rrethin e vrimës në të cilën predha kalon. Në skajet e vrimës së krijuar në këtë mënyrë mbetet sasia më e madhe e gjurmës që gjendet në sipërfaqen e predhës gjegjësisht të të djegurave të barutit, antimonit, bariumit, plumbit dhe paraqitet sasia e caktuar e bakrit e cila ka prejardhjen nga mbështjellësi i predhës. Procesi i njejtë krijohet edhe me kalimin e predhës nëpër lëkurë të victims, me kusht që lëkura të jetë pengesa e pare në të cilën hasë predha.

Me metoda bashkëkohore dhe spektrokimike e këto me spektrografiemisionale, e veçanarisht në kohët e rreza të spektrofotometrisë të paflaktë atomike – absorbcione, është i mundëshëm detekcioni i lehtë i gjurmëve në hapsirat hyrëse të predhës. Me analizat të këtilla përcaktohet nëse ndonje hapsirë hyrëse është krujuar me kalimin e prijektilit të shkrepur ose në ndonjë mënyrë tjetër p.sh shpuarja e teshave me gërshërë, gjilpërë, lime ose futjen e predhës së pashkrepur nëpër tekstil.

Sa i përket ekspertimit teknikobalistik të povava material balistike, eksperti Shpëtim Huda në mënyrë profesionale dhe shkencore trajton dhe sqaron përcaktimin e llojit të armës në bazë të gjurmëve të lënë në gëzhoje dhe përcaktimin e kalibrit të predhave. Sipas këtij autori, armët të të njëjtit kaibër përdorin municione të modeleve të ndryshme. Për armë me veprim mekanik të mekanizmave (nga lloji e modeli i fishekut) gjykohet se i përket „X”- tipi arme.

Kjo për faktin se në gëzhojë kjo kategori armësh lë vetëm një gjurmë, atë të gjilpërës në kapsollë e cila në asnjë rast nuk identifikon llojin dhe modelin dhe armës që ka qitur atë. Për këtë kategori armësh shumë vende kanë prodhime municioni që i përshtatet modelit i kalibrit të armës. P.sh pushkët Italiane janë të kalibrit 6.25mm dhe fisheku është i vacant si në formën e gëzhojës (shishe), ashtu edhe të predhës (cilindrike, me majë ovale).

Po kështu revolveri „nagant” përdorë fishek të vacantë ndryshe nga tipat dhe modelet tjera të revolvereve, ku fisheku është i ndërtuar në mënyrë të tillë që predha të futet në thellësi të gëzhojës. Pushkët gjermane kanë caliber të vacantë (7.92mm) dhe përdorin municion të vacantë, fishek me gëzhoja në formë shisheje dhe predhë në formë konike me majën të theksuar. Pushkët e prodhimit Rusë, Jugosllav dhe Kinez të kalibrit 7.62mm përdorin të njëjtin model fisheku me përbërje gëzhoje në formë shisheje me fund të gjërë dhe predhë në formë konike, me majë të theksuar.

Për pushkët e saktësis së lartë (snajperat) që përdoren për veprime special dhe mekanizmat e të cilave funksionojnë në mënyrë manual haste i njëjti model municioni, me fishekë me përbërje gëzhoje në formë shisheje dhe predhë konike. Por armët ku mekanizmat janë me veprim gjysëmatomik përcaktimi i llojit të modelit të armës bëhet në bazë të karakteristikave grupore të gjurmëve që lënë pjesë të mekanizmave. Kjo kategori armësh dallohet sepse nuk pasqyrojnë gjurmën e dritares. Për armët me veprim automatik, përcaktimi i llojit të armës bëhet

në bazë të karakteristikave grupore të gjurmëve të mekanizmave, ku gjejnë pasqyrim dhe gjurma e buzëve të dritares. Tek armët që përdorin të njejtin model e calibër municioni, ku karakteristikat grupore janë të dalushme nga njëra tjetra. P.sh armët që përdorin municion të modelit 56, kal. 7.62mm, si pushkët model 56, pushkët model 63, automaticët model 56 dhe mitralozët e lehtë model 56, dallohen nga njëri tjetri nga veçantitë e forms dhe vendosjes topografike të gjurmëve që lënë mekanizmat e armës në gëzhgjë.

Përcaktimi i modelit të armës bëhet edhe në bazë të predhave të qitura prej tyre, pasi karakteristikat grupore të gjurmëve të evidentuara në predha kanë veçanti nga njëra armë tek tjetra, si në numrin e gjurmëve të vjaskave, vendosjen e tyre në raport me predhën, pjertësia e drejtimit të tyre, gjerësia etj.

Kjo ilustron me faktin se fishekë të kalibrit 9mm përdoren pistoletat dhe automatikët, por sasia e gjurmëve të vjaskave vijon nga 4 – 6 nga një lloj e model arme, nga një lloji e model arme tjetër. Në këtë rast ekzaminimi për përcaktimin e llojit e modelit të armës mbi bazën e gëzhgjave e predhave bëhet me metodën e krahasimit, ku ballafaqohen karakteristikat grupore të provave material balistike objekt ekspertimi me ato të modeleve të koleksionuara si dhe katalogët përkatës. Ndërsa përcaktimi i kalibrit të predhave ka një trajtim specific dhe professional për të cilin, midis tjerash theksohet: në praktikën e punës ndodhë që shpesh predha e qitur me armë zjarri, mund të dale nga trupi i victims e të humbasë në vendin e ngjarjes, gjat dhënies së ndihmës së shpejtë e të dëmtuarit ose mund të mos gjendjet në mbetjet skeletike të sajë. Përcaktimi i kalibrit të predhës është i rendësishëm për hetimin e veprave penale, ku si mjet krimi kanë shërbyer armët e zjarrit.

Në këtë mënyrë ekspertët ligjorë mund tu kërkohet të përcaktojnë kalibrin e predhës, duke shqytuar indet e zones së dëmtuar për të gjithë ato raste ku predha mungon. Dhe nëse do të bëhej fjalë për lëkurën ekspertët ligjorë bëjnë të ditur se diametric i hyrjes n uk mund ,, të përdoret’’ për përcaktimin e kaibrit të predhës.

Me këtë logjikë mund të shkaktohet vrimë hyrjeje me diameter më të vogël, pra me diametrin që do ti korespodonte një predhe një calibër më të vogël se ai real dhe anasjelltas. Madhësia e dëmtimit është funksion i diametrit të predhës, elasticitetit të lëkurës dhe lokalizmit

të dëmtimit. Nëse lëkura është e leshuar ose fortësisht e tendosur ndikon në madhësinë e dëmtimit. Por nëse dëmtimi me armë zjarri është i lokalizuar në kockë, ai paraqitet në formë rrethore dhe i shprehur mire dhe është logjikisht e pranueshme nëse deklarohet se diametrik i dëmtimit (çarjes) reflekton atë të predhës.

Eksperienca e deritanishme dëshmon se mjaft dëmtime në kockë i përafrohen kalibrit të njohur të predhës që i ka shkaktuar ato, por mundësia e parashikimit të kalibrit prej madhësisë së dëmtimit mbetet evasive. Është shqyrtuar lidhja midis kalibrit të predhës e diamterit të vrimës së hyrjes në kockat e kokës. Përveç kësaj, ndryshimet që ndikojnë negativisht në hamendësin e kalibrit janë përcaktuar. Këto ndryshime njihen nga ekspertët e kriminalistikës, por ato janë ose të panjohura ose të kuputara jo drejt nga antropologët.

Përpunimi rutinë i dëmtimit të kockës reduktohet me etjen e indeve të buta, vajrave dhe mbetjeve të tjera. Me gjithë modelet me dëmtime të shkaktuara një numër i konsiderueshëm armësh në dipozicion u eksperimentuan (përdorën) vetëm predha të kalibrit 22,35,38mm. përzgjidhja u rezervua për dëmtimet e shkaktuara nga predha me caliber të njohur, të gjetura, për të cilat nuk ka tregues se vrima e hyrjes mund të jetë shkaktuar nga një copes predhe.

Çdo dëmtim hyrës vlerohet prej kufijve të jashtëm, si të ishte njësuar me një konturë rrethore të mprehtë. Vlerësot diametrik maksimal i dëmtimit hyrës, ndonëse një i tillë i dëmtuar tej dimensioneve të predhës paraqitej mjaft problematik. Dëmtimet e shkaktuara nga predha të kalibrit 38 inç paraqiten dukshëm më të gjërë se ato të shkaktuara nga predha të kalibrit 22 dhe 25 inç. Ndërkohë që midis dëmtimeve të shkaktuara nga këto të fundit vihen re diferenca të vogla.

Ndërkaq, diametrik mesatar dhe vlerat ekstreme të dëmtimeve të shkaktuara nga predha të kalibrit 25 inç paraqiten më të vogla se ato respective për dëmtime të shkaktuara nga predha të kalibrit 22 inç. Me këtë rast duhet veçuar disa karakteristika të ekspertimit teknik të armëve të ftohta, sipas studimit të eksperiti Sh. Huda, armët e ftohta janë mjete të përgaditura posaçërisht ose të përshtatura për qëllime luftarake, për të shkatuar dëmtime trupore ose vdekjen. Quhën armë në kuptimin e ligjit „për armë” armët e zjarrit të çdo lloji e kalibri (armët luftarake e sportive, gjuetie e special dhe të prodhuar e të përshtatura në mënyrë artizanale), municionet e tyre, bombat e minat, si dhe armët e ftohta (si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjetet e tjera të përgaditura e të destinuara posaçërisht për sule ose për vet mbrojtje).

Janë përcaktuar dy kategori armësh të ftohta: Grupi i parë përfshinë shpatat, bajonetat e thikat, të përcaktuara drejtpërdrejt si „armë të ftohta”, dhe grupi tjetër përfshinë mjetet e tjera të përgaditura e të destinuara psacësisht për sul ose për vetmbrojtje.

Armët e ftohta paraqiten me the e pa the. Në vartësi nga destinacioni i prodhimit, armët e ftohta me the ndahen në: çarëse (shpatat, anxharet), shpuese – çarëse (bajonetat gjilpërë, pinjallët, stiletet) dhe shpuese – prerëse (bajonetat me the, thikat ushtarake, kamat, thikat Firlandeze e të gjahut). Kurse armët e ftohta pa the janë ato mjete që kanë veprim dërmues ose goditës. Armët e ftohta janë tri llojëshe: prodhim fabrike, artizanale dhe të përgaditura ose adaptuara vetë.

2.1 Revolverët

Revolverët janë armë me mulli rrotullues, në të cilën vendosen fishkët. Revolveri është me vjaska, jo automatik dhe me tytë të shkurtër. Ndryshe nga pistoleta, veprimi i qitjes me revolver nuk është i automatizuar, por bëhet mekanikisht, duke tërhequr këmbëzën e shprepjes. Revolveri bën pjesë në grupin e armëve të shkurtra, i cili gjat tërheqjes së këmbëzës gjuhet vetëm plumbi i asaj komore në atë moment përshtatet gypi i tytës me gypin e mullirit rrotullues. Në varësi nga mehanizmi i shkrepjes dallojmë revolver njëkahës (Single Action) dhe dy kakshe (Double Action).



Fig.1 a)

a)

Revolverët dykahësh në numër të madh rastesh mund të funksionojnë edhe në një kahje.

Veprimi njëkahësh (Single Action) arrihet kur kryhet tërheqja e këmbëzës, me tërheqjen e goditësit me ndihmën e gishtit të madh, pastaj duhet të meret shënjestra dhe kryhet gjuajtja, nën veprimin një kahësh tërheqja e këmbëzës është shumë më lehtë dhe na mundëson precizitet më të madh në gjuajtje.

Veprim dy kahësh (Double Action) arrihet me tërheqjen e këmbëzës, ku në veprimin e parë arrihet ngecja e goditës (i cili ka qenë në gjendjen e mëparshme), i njëjti zbrapset dhe përsëri menjëher nis drejt para (veprimi i dytë) me të cilën është kryer tërheqja e këmbëzës si në fig.2.



Fig.2

kjo mënyrë e tërheqjes së këmbëzës është diçka më e rëndë nga veprimi një kahësh dhe si prapavijë e kësaj paraqitet më pak precizitet në qëllimin e shënjestrës. Megjithatë kjo mënyrë e tërheqjes së këmbëzës mundëson hapje të shpejt të zjarrit gjat gjuajtjes me revolver.

2.1.1. Pjesët përbërëse të revolverit:

Revolveri i cili është i paraqitur ne figure si p.sh modeli CZ 83, nga prodhuesi Zastava. Ky revolver është i përbërë nga pjesët në vazhdim: Cevi, Rami bashkë me dorëzën për ta mbajtur, Cilindri, Siguresa e cilindrit, Një bar me të cilin plumbat hedhen përmes një tërheqës, Goditësi, Këmbëza, Mbrojtja e këbëzës, Shënjestra e pare dhe shënjestra e Mbrapshtë.



Fig.3

1. Cevi: është i projektuar që kokrës së plumbit ti jape drjetim me rrotullim rreth cevit të vet për shpejtësin dhe stabilitetin gjat fluturimit.
2. Rami bashkë me dorëzën për ta mbajtur: është i projektuar që të bashkoj të gjithë pjesët të revolverit në një tërësi dhe të mundësoj përdorim të rahatshëm gjat qitjes.
3. Cilindri (barabani): është i projektuar për strehim të pesë apo më tepër plumbave të cilat janë strehuar në pesë spo mëtepër strehues plumbash.
4. Siguresa e cilindrit: është i projektuar që ta vërtetoj cilindrin (barabanin), pas sjelljes në kuadër të ramit bashkë me dorëzën për ta mbajtur dhe prëputhja në njërën nga strehuesit të plumbit me cevin.
5. Shënjestra: është i projektuar për shënjestrim precizë të armës drejtë qëllimit ku duhet të përputhen shënjestra e pare me atë të mbrapshtën.

2.1.2. Municioni i cili përdoret për revolverin:

Municion me ndezje nga këndi: nuk ka ndonjë kapisël special, por përzierja ndezëse është vendosur nëpër këndin e gëzhjës. Ekzistojnë mëshum lloje të municioneve me ndezje nga këndi të cilat dallohen mes veti nga gjatsia e gëzhjës, gjatsia dhe masa e kokrës, masa e mbushjes dhe llojet e barutit. Kalibra të municioneve me ndezje nga këndi janë: 22 Cal konkretisht 5.6 mm, dhe është e njohur me emrin si municion i kalibrit të vogël. Më i njohur dhe më përdorur plumb me ndezje nga këndi në të gjithë botën është 22 LR (22 Long Rifle). Si në fig.



Municion me ndezje q nrore: kapisla iniziale q  e ndez ndodhet n  mes t  g zhoj s. Te municioni mendezje q ndrore, kalibra m  t  njohur dhe m  t  p rdorur t  revolverit jan : 38 Special, 357 Magnum, 44 Mgun, 44 Rem. Magnum dhe 500 Magnum, ekzistojn edhe shum  lloje tjera kalibrash p r revolver. Si n  fig.



Ekzitojn shum  lloje tjera t  revolverve ku si p.sh modele m  t  njohura me brend botror  jan :

1. Smith and Wesson, modeli i pare revolver i kalibrit 22, n  vitin 1857.
2. Gaser modeli 1870, revolver Amerikan.
3. Taurus revolver Brazilian i modelit 38101SO ne vitin 1941.
4. Revolveri Colt i prodhimit Amerikan 45 colt n  vitin 1872
5. Zastava M83 Rvolver i modelit Jugosllav n  vitin 1983.

Historiku (sh noe vet)

Kah fundi i shek. XIX jan  p rpunuar dhe jan  zbatuar disa shpikje mekanike t  cilat edhe sot merren si shpikje moderne te revolver t, si p r shembull korniza monolite, sisteme t  ndryshme t  sigurimit t  shkrep sit, pllaka prej  eliku q   sht  e vendosur mes shkrep sit dhe gjilp r s ndar se t  saj, cilind r q  hidhet an sh nga sh njestrat p rshtat se. Zhvillimi i revolverit p rfundon me barutin nitroceluloz  n  vitin 1888. Duke par  k t  konstruktivisht, revolveri i sot m e ka marr  form n e vet kah fundi i shek. XIX. P rparimi konstruktiv  sht  arritur me

përdorimin e spiraleve të lëmuara duke zëvendësuar ato të pjerrëtat. Revolveri ka arritur zhvillim të hovshëm me përdorimin e gypave të pastra rezistente të cilat njëkohësisht mundësojnë përdorimin e municionit më të fortë. Me këto risi revolveri bëhet armë më e sigurtë për mbrojtje

2.1.3 Pistoletat

Pistoletat janë armë me tytë të shkurtër me vjaska dhe vetmbushëse një gjuajtës, gjysmëautomatike dhe automatike. Futja e fishekut në fole, jashtëqitja e gëzhgjës së zbrazur, marja e fishekut të rradhës dhe vënja e rrafshit në pozicion zjarri kryhen me fuqin e qitjes.

2.1.4 Pistoletat me një gjuajtje

Te pistoletat një gjuajtje gypi me ndihmën e mehanizmit për hapje e cila hapet, ku në menyra dirkete me anë të dorës vendoset plumbi në gyp. Pas mbylljes së cevit te pistoleta arma është e gatshme për përdorim dhe me tërheqjen e këmbëzës vjen deri tek gjuajtja e plumbit. Pistoletat me një gjuajtje kryesisht janë me një apo dy gypa, mirpo ekzistojnë edhe pistoleta një gjuajtse me më shumë gypa. Fig...



2.1.5 Pistoletat gjysmëautomatike



Te pistoletat gjysmëautomatike me tërheqjen e mbështjellësit mbrapshtë, ndalohet goditësi, dhe me lëshimin kthehet në gjendjen e mëparshme, mbështjellësi e kap plumbin nga rami i mbushjes dhe e shtyn në tytë, me të cilën pistoleta është e mbushur dhe i gatshëm për gjuajtje. Me tërheqjen e këmbëzës mbrapsht me gishtin tregues, vjen deri tek lirimi i goditësit. Gotizësi nën ndikimin e shtresës vet niset përpara, godet gjilpërën, kurse kjo te kapisla e plumbit me të cilën gjuajtja është kryer. Pas gjuajtjes së kryer nën ndikimin e garzave të barutit, koka e plumbit del nga tyta, mbështjellësi kthehet mbrapsht, me të së cilës kryhen këto funksione:

- Zhbllkohet tyta.
- Tërhiqet dhe hidhet gëzhoja me ndimën e tërheqjes dhe hedhësit
- **Се врши збивање на повратната пружина.**
- Ndërpritet funksioni i këmbëzës me ndihmën e një ndërprerësi të këmbëzës, me të cilën ndalohet zjarr automatik.
- Ndalohet goditësi.
- Bartësi dhe shtrirësi nga rami e shtyn plumbin i rradhës me ballin e mbështjellësit.

Përshkrim i pjesëve të pistoletës modeli CZ 99



Fig. a

Tyta – është i projektuar që në të, të kryhet gjuajtja e plumbit dhe që kokrës së plumbit ti jape drejtim me rrotullim rreth boshtit të vet, shpejtësi dhe stabilitet përgjat fluturimit.

Mbështjellësi me shënjestër – është e projektuar që ta sjellë plumbin në tytë, të kryej gjuajtjen, të tërheq dh eta hedh gëzhjojën. Nga pjesa e brendëshme e mbështjellësit ka ulluk të zgjatur të cilat mundësojnë bashkimin me dorëzën për ta mbajtur.

Mekanizmi kthys – është i projektuar që pasi të kryhet gjuajtja dhe hedhja e gëzhjojës, mbështjellësi kthehet në gjendjen e mëparshme.

Rami me dorëzën për ta mbajtur – është i projektuar për e mekanizmit për ngecje dhe tërjeqje, rami i municionit, për bashkimin dhe udhëheqjen e mbështjellësit të mbyllur.

Mekanizmi për tërheqjen e këbëzës – ekzistojnë më shumë lloje të mekanizmave për tërheqje të këbëzës të cilat përdoren te pistoletat. Ato janë: aksion njëkahës – “SA” (Single Action), aksion dy kahësh – “DA” (Double Action), vetëm aksion dykahësh – “DAO” (Double Action Only), aksion i sigurt – “SFA” (Safe Action), aksion i shpejtë – “FA” (Fast Action) etj.

Përshkrimi i pjesëve të pistoletës së çmontuar e cila është paraqitur në figuren në vijim...

2.1.6 Pistoletat automatike

Pistoletat automatike pothuajese janë të njëjta me pistoletat gjysmëautomatike përveçse ndryshon funksionimi i tyre gjat gjuajtjes. Se te pistoletat gjysmëautomatike ekziston funksioni i cili e ndërpret funksionin i këmbëzës me ndihmën e një ndërprerësi të këmbëzës, me të cilën ndalohet zjarri automatic, ndërsa te pistoletat automatike nuk ekziston ndërprerësi i këmbëzës si te pistoletat gjysmëautomatike por këmbëza është e liruar. Pistoleta më e njohur automatike të cilën e prodhon shteti Austriak dhe SHBA – të e cila është një nga më të nojurat është i njohur si modeli **Glock** – full auto. Si në figurën në vijim....



Pushkët

Përkryerja e rëndësishme e pushkëve bëhet me zbulimin e kapsollës në fillim të shekullit XIX. Në mesin e pushkëve më të rëndësishme janë llojet e ndryshme të pushkëve ushtarake të cilat në pjesën e brendëshme të tytës kanë lugosje me 4-6 ullukë, të cilat shkojnë paralelisht dhe në mënyrë helikoidale njëra me tjetrën. Automatikët janë armë zjarri plotësisht të automatizuara me tytë gjysëm të gjatë dhe me vjaska.

- Pushkët (karabinat) janë armë zjari me tytë të gjatë, me vjaska. Disa prej tyre janë gjysmëautomatike, sepse bëjnë veprimin e jashqitjes së gëzhgjës së zbrazur me marjen e fishekut të rradhës në fole në mënyrë automatike, ndërsa qitjen e kryejn një nga një, me heqjen e këmbëzës së shkrepjes. Në praktikë haste më shpesh pushka model 56, caliber 7.62 mm.

- Pushkët e gjahut me tytë të lëmuar quhen saçmare dhe zakonisht kanë dy tyta ndërsa ato me tytë të lugosur quhen karabina. Armët e gjahut janë me dy tyta – çifte ose me një tytë teke, përveç këtyre ka edhe armë të gjuetisë të cilat janë me një tytë por kryejnë funksion gjysmëautomatik. Pushkët e gjahut (saçmaret) janë lloji i armëve të zjarrit, tyta e të cilave nuk është e lugosur (me tytë të lëmuar) dhe fishekët e sajë kanë përbërje tjetër nga fishekët e armëve të zjarrit, tyta e të cilave është e lugosur.

Pushkët (Karabina)

Karabinat janë pushka të cilat cevi i tyre është me vjaska gjat gjithë gjatësisë së tyre, për dallim nga pushkët saçmare të cilat tytën e kanë të lëmuar. Pushkat me tyta me vjaska (karabinat) mund të jenë një gjuajtës, përsëritës dhe gjysmëautomatike.

Karabin me një gjuajtje – gjuajtjen e kryejnë me anë të mbushjes direkte apo vendosjes së plumbit direkt në tytë nga ana e përdoruesit dhe në atë mënyrë arma është e gatshme për gjuajtje. Si në fig.



Karabinat përsëritës – përsëritjen e kryejnë me anë të dorës në tri mënyra:

- a) me shtyerjen e mekanizmit për mbështjellje me rrotullim dhe tërheqje (apo vetëm me tërheqje) të dorzës së mbështjellësit (Bolt Action). Si në fig.



- b) me ndihmën e llozit (Level Action). Si në fig.



- c) me ndihmën e mekanizmit të pompimit (Pump Action). Si në fig.



Karabinat gjysmëautomatike (apo ato të modernizuara) janë karabina të cilat përdoren më së shumti për shërbime ushtarake apo policore, poashtu edhe për gjueti, këto karabina punon e tyre e kryejnë në mënyrë automatike me tërheqjen e këmbëzës ndizet kapsolla e plumbit, me anë të garzave të barotit mbështjellësi kthet mbrapsht, hidhe gëzhoja dhe në mpyrë automatike vihet në tytë plumbi i rradhës, këto karabin kanë magazine me kapacitet 5 – 10 plumba. Si ë fi



Si karabina (snajpera) më të njohura dhe më të përdorura nga ana e ushtrisë dhe policisë janë: Karabina (snajpera) gjysmëautomatike M76, 7.9 mm.

Qëllimet dhe aftësitë luftarake të pushkës AP 7.62 mm, M – 70, AB2



Karabina (snajpera) 7.9 mm M – 76 shërben për eliminimin e qëllimeve (jo lëvizëse, momentale, lëvizëse) dhe qëllime të gjalla të maskuara në largësi më të mëdha.

Qëllimi taktik: qëllim i sukseshëm për të zabuluar dhe për të parë mire me këtë pushkë (snajper) gjatë ditës arihet deri në 1000 m largësi. Qëllimi më i sukseshëm arihet në largësi prej 800 m. Në qëllime ajrore në mënyrë të sukseshme mund të gjuhet deri në 500 m. qëllim i sukseshëm gjat natës mund të arrihet deri në 400 m. nëpërmejt shënjestrës optike largësia është

deri në 1200 m, ndërsa mekanike 1000 m. largësia maksimale e qitjes së kësaj pushke është deri në 5000 m.

Kjo pushkë (snajper) gjysmëautomatike në pëmbledhjen e saj ka thikë me gërshërë e cila shërben për ndeshje të afërme me armikun, kurse bashkimi i të dyjave thikë dhe gërshërë shërben për prejen e telave pengues, linjat telefonike dhe të tjera.

Puska mbushet me karikator e cila merr 10 plumba, kurse shkathtësia e gjuajtjes e kësaj pushke gjat luftimit është 30 plumba në minut.

Kjo pushkë snajperike (PASP) i ka këto pjesë kryesore:



1. tyta me vrimat për gazrat e barutit
2. dhoma me gaz me rregullator të gazit
3. Arkivoli me një dorezë
4. Mbulesa e arkivolit
5. Cilindri i gazit
6. Mekanizmi për tërheqjen e këbëzës
7. Bartësi i mbështjellësit me piston
8. Mbështjellësi
9. Mekanizmi kthyes
10. Shtresa e drurit
11. Bishti

12. Thikë me gërshërë
13. Shënjestra e perparme
14. Shënjestra e mbrapshme
15. Karikator (kornizë)
16. Mjetet reserve dhe vegla

KARAKTERISTIKAT TAKTIKE DHE TEKNIKE	
Kalibri	7.9 mm
Masa e pushkës PASP pa shënjetrën optike	4.6 kg
Masa e shënjestrës optike me bartësin	0.65 kg
Masa e karikatorit (kornizës) së zbrazët	0.23 kg
Gjatësia e pushkës PASP	1135 mm
Gjatësia e tytës	550 mm
Numri i vjaskave të tytës	4
Fillimi i shpejtësisë së kokrës	730 m/s
Kapaciteti i karikatorit (kornizës)	10
Forca e shkëputjes	Deri 2.5 N
Shtypja maksimale e gazrave të barutit	3200 bar

Pushka (snajpera) largëgjyajtëse M93 12.7 mm – shigjeta e zezë.

Snajperat larg gjyajtëse si Shigjeta e Zezë M93 12.7 mm, është e prodhuar si shembull i sistemit MAUZER. Qëllimi kryesor i kësaj pushke është ndikimi i qëllimeve pak të dukshme në largësi të mëdha. Për këtë arsye pushka vetëm shënjesët optike, i cili ndodhet në paket me armën (zmadhimi 8x e ndarë me 1800 m). bartësi mund të mbajë edhe shënjestër nga prodhuesit e tjerë.



Karakteristikat kryesore:

1. Baraspesh e perkryer
2. Bishti me dy amortizime
3. Siguresa e gazit e cila e lehtëson gjyajtjen (e zvoglon dridhjen deri në 62 %)
4. Bishti dhe shtresa (veshja) janë të përbëra nga polimeri, e përforcuar me fije të holl prej qelqi
5. Dy këmbët mbështjellëse të cilat shërbejnë për vendpsjen e baraspeshës së pushkës
6. Bllokimi sipas sistemit MAUZER
7. Mbështjellësia ka udhëheqës gjat gjith rrugtimit të tijë në arkivolin
8. Masa e tytës së rrëndë mundëson shënjestër dhe rrugtim të sakt gjat proektili me energji potenciale



KARAKTERISTIKAT TAKTIKE DHE TEKNIKE

	DSHK	BROVING
Kalibri	12.7 x 107	12.7 x 99
Masa (kg)		
Arma	16 kg	14.5 kg
Shënjestra optike	0.73	0.73
Gjatësia (mm)		
Arma	1670 mm	1510 mm
Tyta	1000 mm	840 mm
Karakteristikat mekanike		
Lloji i gjuajtjes	Një gjuajtëse	Një gjuajtëse
Sistemi i bllokimit	Mauzer	Mauzer
Kapaciteti i kornizës (plumba)	5	5
Shpejtësia fillestare	820 m/s	888 m/s
Largësia maksimale efektive	1600 m	1600 m

FALKON 12.7 mm

Pushka snajperike largëgjuajtëse Falcon 12.7 mm, është e prodhuar prej sistemit Mauzer. Qëllimi kryesor i kësaj pushke është ndikimi ndaj shënjestrave pak të dukshme në largësi të mëdha. Pushka ka vetëm shënjestër optike i cili ndodhet ne paketin e armës. Mbajtësi mund të pranoj shënjestra nga prodhimet tjera. Shfrytëzohet në përbërjet e njësive speciale ushtarake dhe policore.



Fig...

Karakteristikat kryesore:

1. Baraspesh e përkryer
2. Bishti me dy amortizuaes
3. Siguresa e gazit e cila e lehtëson gjuajtjen
4. Bishti dhe shtresa (veshja) janë të përbëra nga polimeri, e përforcuar me fije të holl prej qelqi
5. Dy këmbët mbështjellëse të cilat shërbejnë për vendpsjen e baraspeshës së pushkës
6. Bllokimi sipas sistemit MAUZER
7. Mbështjellësia ka udhëheqës gjat gjith rrugtimit të tijë në arkivolin
8. Masa e tytës së rrëndë mundëson shënjestër dhe rrugtim të sakt gjat proektili me energji potenciale

KARAKTERISTIKAT TAKTIKE DHE TEKNIKE

	DSHK	BROVING
Kalibri	12.7 x 107	12.7 x 99
Arma	13.4 kg	12.9 kg
Arma	1380 mm	1260 mm
Tyta	927 mm	839 mm
Karakteristikat mekanike		
Lloji i qitjes	Një gjuajtëse	Një gjuajtëse
Sistemi i bllokimi	Mauzer	Mauzer
Kapaciteti i kornizës (plumba)	2	2
Shpejtësia fillestare	820 m/s	888 m/s
Largësia maksimale efektive	1600 m	1600 m

Barrett .50 Caliber Overview 20 mm (M107 dhe M82 A1)

Kjo pushkë snajperike është një nga llojet e kalibrave më të mëdha nga ky lloj i armëve ecila përdoret gjegjësisht nga ana e ushtrisë Amerikane dhe Canadeze për qëllime shumë të largëta dhe pak të dukshme për eliminimin e tyre. Pushka mund të mbaje lloje të ndryshme të shënjestrave optike dhe mban një karikator (kornizë) prej 10 plumbash, funksionimi i kësaj pushke mund të jetë një gjuajtëse me përsëritje, por edhe gjysmëautomatike.



Si ne fig....

Largësia maksimale e cila është aritur nga pushka snajperike 12.7 mm nga snajperisti i njohur Amerikan Chris Kyle është 2430 m, i cili ka aritur sukseshëm të eliminoj një Taliban në luftën e Afganistanit dhe kjo konsiderohet si aritja më e largët e gjuajtjes, ndërsa vitin e kaluar rekordin e aritjes së qëllimit të gjuajtjes me pushkë snajperike është aritur nga snajperisti Kanadez i cili ka eliminuar një pjestarë të ISIS në largësi prej plot 3540 m, dhe kjo njihet si aritja e qëllimit të objektivit më largët në historinë e deritashme të luftrave, pushka snajperike thuhet se ka qenë e kalibrit 50 – 20 mm, rreth identitetit të snajperistit nuk ka informata tjera personale.

Pushkët saçmare (pushkët e gjahut)

Pushkat saçmare janë pushkë tytë i të cilave është i lëmuar pa vjaska për dallim nga tyta e karabinës të cilat janë me vjaska.

Ekzistojnë më shumë lloje të pushkëve saçmare dhe atë:

1. Pushkë saçmare me thyerje – me një apo dy tyta të vendosura në mënyrë horizontale apo vertikale të cilat thyhen. Si në fig...



2. Pushkë saçmare me përsëritje (me pompim), plumbat vendosen në magacionin e tytës, por me zhvendosjen e bishtit të përparëm, para dhe mbrapsht mbushet dhe zbrazet pushka dhe kryhet gacja e mekanizmit për tërheqjen e këmbëzës. Si në fig...



3. Pushkët me përsëritje mund të jen me lëvizje mekanike të mbështjellësit me ndihmën e rrotullimit dhe tërheqja e dorëzës së mbështjellësit (Bolt Action) si në fig...



4. Pushka gjysmëautomatike saçmare funksionon në principin e huamarjes të gazrave të barutit për hedhjen e gëzhjës së gjuajtur dhe për marjen e plumbit të ri nga magazine e tytës. Fi në fig....



Përshkrim i pjesëve të pushkës saçmare

Pushka saçmare është e ndërtuar prej pjesëve si:

1. Bishtit
2. Tytës
3. Llozi për hapjen e tytave
4. Koka e pushkës
5. Nënbishtit
6. Këmbëza
7. Mbrojtësi i këmbëzës
8. Ura e shënjestrës

9. Shënjestra e përparme



Fi në fig.....

Kemi disa lloje të diametrave të pushkave saçmare të ndara në kalibra të ndryshme të cilët janë paraqitur në tabelën në vijim:

Paraqitja e kalibrit	Diametri i tytës në (mm)
Kalibri 4	26.72 mm
Kalibri 6	23.35 mm
Kalibri 8	21.21 mm
Kalibri 10	19.69 mm
Kalibri 12	18.53 mm
Kalibri 14	17.60 mm
Kalibri 16	16.83 mm
Kalibri 20	15.63 mm
Kalibri 24	14.70 mm
Kalibri 28	13.97 mm
Kalibri 32	13.36 mm
Kalibri 36/.410	12.85 mm

Prej këtyre kalibrave të pushkave saçmare më të përdorura janë: Kalibri 20, me diameter 15.63 mm, Kalibri 16 me diametër 16.83 mm dhe më i përdoruri është pushka me caliber 12 me diameter prej 18.53 mm.

Te pushkët saçmare rol shumë të rëndësishëm luan edhe **çoku** i cili është i vendpsur në pjesën e përparme të tytës dhe shërben për tu dhënë drejtimin e gjerësis dhe largësis së saçmave.

Në tabelën në vijim është paraqitur një pamje anësore të një pengese (chock) të ngushtimit:

Lloji i pengesës (Chock)	Ngushtimi
1. Super pengesë (Chock)	1.20 – 1.25 mm
2. Penges (Chock) e plotë	0.90 – 1.10 mm
3. Penges (Chock) $\frac{3}{4}$	0.80 – 1.00 mm
4. Penges (Chock) $\frac{1}{2}$	0.30 – 0.70 mm
5. Penges (Chock) $\frac{1}{4}$	0.10 – 0.20 mm
6. Cilindri	Nuk ka ngushtesë



Si ne fig...

Municioni i pushkës saçmare

Plumbi i projektuar për gjuajtje nga pushka saçmare përbëhet prej pjesëve në vijim:

Gëzhoja, Kapsola, Mbushja e barutit, Prizë, Ena plastike bashkë me saçmat, dhe më lartë kapaku mbështjellës. Municioni i pushkës saçmare përbëhet sipas llojeve të kalibarave, por gjatësia mund të jetë e ndryshueshme siç janë: 50 mm, 60 mm, 65 mm, 67 mm, 70 mm, 73 mm, 76 mm dhe 89 mm.

Lloji i municionit më atraktiv që përdoret për pushkat të kalibrit 12 mm ndahet në tre grupe dhe atë:

- Municioni i thjeshtë 12/70 mm
- Municioni magnum 12/76 mm
- Municioni super magnum 12/89 mm

Në tabelën në vijim janë paraqitur diamterat e saçmave në millimeter të llojit „Bellom” Srbija

Diametri i saçmave në (mm)	Maraka e saçmave „Bellom” Srbija
8.50 mm	PP
5.50 mm	00
5.25 mm	0
5.00 mm	2
4.50 mm	4
4.00 mm	6
3.50 mm	8
3.00 mm	10
2.50 mm	12
2.20 mm	14
2.00 mm	15
1.70 mm	16

Në një plumb të kalibrit 12 me mbushje normale ka 60 pjes te saçmave me diameter prej 4.5 mm. gjithashtu edhe mbushja e plumbit mund të përmbaj edhe sasi të ndryshme të mbushjes së barutit.

Në tabelën në vijim do ti paraqesim mënyrat e paraqitjes së saçmave në SHBA, FRANCA, GJERMANI, SPANJË, ANGLI, NORVEGJI dhe ITALI.

Diametri i saçmës në (mm)	Marka e madhësis së saçmës në: SHBA, FR, GER, ESP	Marka e madhësis së saçmës në: ENGL, NOR,	Marka e madhësis së saçmës në: ITA,
2 mm	9	9	9
2.25 mm	8	8	8
2.41 mm	7 ½	7	7 ½
2.5 mm	7	6 ½	6
2.75 mm	6	5	6
3.0 mm	5	4	5.4
3.25 mm	4	3	3
3.5 mm	3	2	2
3.75 mm	2	1	1
4.0 mm	1	BB	0
4.5 mm	BB	/	4/0
5.16 mm	T	AAA	/
5.56 mm	F	/	6/0
6.09 mm	No.4	/	/
6.22 mm	No.3	/	7/0
6.83 mm	No.2	SSG	8/0
7.62 mm	No.1	Spec Sg	9/0
8.13 mm	No.0	/	10/0
8.43 mm	No.00	SG	11/0
9.14 mm	No.000	LG	12/0

Pushkët automatike

Pushka automatike 7.62 mm, M70

Qëllimet dhe tiparet luftarake: pushka automatike 7.62 mm, M70 (M70A), është e projektuar për azgjësimin e fuqive të gjalla armiqsore dhe mjeteve të zjarrit. Pushka me të cilën është e pajisur me minahedhës, në mënyr të përkryer mund të shfrytëzohet për shpartallimin e automjeteve të blinduara dhe automjeteve tjera luftarake, bukerëve, ndërtesave, tymos dhe nriçon fushën e betejës.



Fig..a) pushka automatike m70b1 dhe b) pushka automatike m70ab2

Rezultatet më të mmira gjat gjuajtjes kundër armikut arihet me: gjuajtje një nga një deri në largësi prej 400m, me përsëritje të shkurtëra deri në 300m, dhe me përsëritje të gjata deri në 200m. me zjarrë në reshtim nga mëshum gjuajtës gjat zbulimit të grupeve dhe qëllimeve mund të gjuhët deri në 600m.

Veprim i sukseshëm me minahedhës është në largësi deri 150m, dhe me mihaedhësin momental dhe tymosës në largësi deri ne 240m. Me minahedhës ndriçues efekt më i sukseshëm arrihet kur ajo do të hidhet në shkallë prej 45° .

Pushka mbushet me karikues prej 30 plumbave. Shpejtësia luftarake e goditje është rreth 200, ndërsa ajo teorike është rreth 600 plumba në një minut.

Pjesët kryesore të pushkës automatike janë:

1. Bishti
2. Mbështjellësi i arkivolit
3. Rregullatori i qitjes
4. Mbështjellësi
5. Akrivoli me dorëzën për mbajtje
6. Mekanizmi për tërheqjen e këmbëzës
7. Karikatori (kornia)
8. Shtresa prej druri
9. Shënjestra e mbrapsht
10. Komorat e gazit
11. Shënjestra granatë
12. Shënjestra e përparme
13. Shufra metalike
14. Mbrojtësi i gojës së tytës



Pushka automatike AK – 47 7.62x39mm

Pushka automatike 5.56mm M21C dhe hedhësi i granatave 40mm



Fig.

Karakteristikat kryesore: pushka autimatike M21C 5.56mm, ka të ndërtuar paftë metalike, e cila mundëson montimin e të gjith mjeteve optike të cilat konvenojn në standardet e NATO.



Fig.

Gjithashtu kjo pushkë është e dizajnuar në mënyrë të përkryer dhe e balansuar që ka:

- Rezistencë e butë dhe është e lehtë dhe kompakte
- System efikas dhe i sigurt i mbylljes
- Sistem i sigurt i mehanizmit për tërheqjen e këmbëzës
- Bishti i ndërtuar prej polimeri me mundësi të shpejt për ndryshimin e pozitës
- Karikator (kornizë) i ndërtuar me kualitet i lartë prej polimeri
- E ndërtuar prej lendëve të para me cilësi të lartë
- Tytë e ftohtë e fërkëtuar, e kromuar mbrenda, precizitet i lartë.

AP ka montim të shpejtë dhe të thjeshtë në hedhësin e nëntytës të granatave të kalibrit 40mm. Goma e patkuar e cila montohet në bisht dhe është pjesë e përbërë e kompletit, mundëson

shënjestër të rahatshme, kur shfrytëzohet hedhësi i granatave. Fshehtësi i flakes e zvoglon mundësin për kontakt me qitësin. Në të njetën kohë, ai ka funksionin e stabilizuesit të armës gjatë gjuajtjes. Pushka mund të ketë përsëritës i kufizuar dhe i kontrolluar prej tre plumbash.



Fig.

Kalibri	5.56 mm
Arma	3.85 kg
Karikatori (korniza) 30 plumba	0.185 kg
Arma	925 mm
Tyta	375 mm
Karakteristikat mekanike	
Mënyra e gjuajtjes	Gjysmëautomatike dhe automatike
Mënyra e punës	Huamarja e gazrave të barutit
Sistemi i mbylljes	Mbështjellësi rrotullues
Shpejtësia e gjuajtjes	560 – 680 plumba/min
Shpejtësia fillestare	914 m/s
Largësia maksimale efektive	500 m



Fig...

Hedhësi i granatave	
Kalibri	40 mm
Masa	1.5 kg
Gjatsia maksimale	323 mm
Gjatësia e tytës	120 mm
Shpejtësia fillestare	76 m/s
Largësia maksimale efektive	400 m
Rrezja e veprimit	20 m
Shënjestra	
Drejt për drejt	50 – 400 m
Indirect	200 – 350 m

Pjesët rezerve dhe pajisjet

- Thikë me gërshërë
- Një alternator për kërkim për municion manevrik (i rejshëm)
- Pajisje për pastrim
- Shufra për pastrim
- Tubi me vaj
- Kaishi
- Katër karikator (korniza) reserve me kapacitet prej 30 plumba.

Automati M85 dhe pushka automatike M90A

AP dhe automati 5.56 mm i kanë pjesët të njëjta përbërëse si dhe AP 7.62mm M70 dhe funksionojnë në të njëjtin princip në huamarjen e gazrave të barutit.



Fig...Automat M85



Fig...Pushk automatike M90A

Karakteristikat kryesore janë:

- Balansim i përkryer
- Shtypje e butë
- Mundësi për shënjestër nate
- System efikas dhe i sigurt për mbyllje

- Mehanizmi i tipit të sigurt për hapje
- Tytë e ftohtë e fërkëtuar e cila mundëson precizitet të lartë

Karakteristikat individuale:

Pushka M90A ka mundësi për shfrytëzimin e minahedhzave (granatave), me shfrytëzimin e shënjestrave granatuese dhe pjesët shtuese të granatës, thika është pjesë përbërëse e kompletit.

Modeli	SMG	AP
	M85	M90/M90A
Kalibri	5.56 dhe 45 mm	5.56 dhe 45 mm
Arma	3.5 kg	4.9 kg
Karikator (korniza) prej 30 plumbave e zbrazët	0.330 kg	0.330 kg
Arma	760 mm	785/985 mm
Tyta	254 mm	460 mm
Karakteristikat mekanike		
Mënyra e qitjes	Selective	Selective
Principi i punës	Huamarja e gazrave të barutit	Huamarja e gazrave të barutit
Sistemi i mbylljes	Mbështjellësi rrotullues	Mbështjellësi rrotullues
Shpejtësia e qitjes	600 plumba/min	600 plumba/min
Shpejtësia fillestare	750 m/s	915 m/s
Largësia maksimale efektive	200 m	300 m

Pjesët rezerve dhe pajisjet

1. Thikë me gërshërë
2. Një alternator për kërkim për municion manevrik (i rejshëm)
3. Pajisje për pastrim
4. Shufra për pastrim
5. Tubi me vaj

6. Kaishi

7. Katër karikator (korniza) reserve me kapacitet prej 30 plumba.



Pushka automatike M4.



Pushka automatike 5.56mm M – 4 bienë familjen e armëve të cilat janë të dala nga version i shkurtër (carbine) të pushkës automatike M16, e cila është variant e pushkës automatike AP – 15 dhe është e dizajnuar nga njëri prej tre dizajguesit më të mir të shekullit XX, Eugene Stoner, ndërsa është e prodhuar nga firma Arma Lite. Pushka automatike M – 4 është e pranuar nga ana e ushtrisë Amerikane në vitet e 90 – ta si versio modern i pushkës automatike M16. Pushka automatike M – 4 popullaritetin e saj e ka arsyetuar te ushtarët me madhësin e saj të përkryer e cila përdoret për luftime të afërta dhe mundëson lëvizje të lehtë në vende luftarake. Pushka automatike M – 4 është version më i shkurtër dhe më i lehtë se pushka automatike M16A2, me 80% të peshës së njëjtë. E njëjta punon në princip me huamarrjen e gazrave të barutit, mbushet nga karikator (kornizë), shfrytëzon ftohje ajrore, ka mundësi për veprim selektiv, veprohet nga krahu me kundak teleskopi dhe është me tytë të shkurtër e cila e lehtëson shfytëzimin për luftime të afërta. Njëjt si modelet tjera të familjes M16 përdor plumba me kalibar 5.56mm. Pushka automatike ka mundësi për veprim selektiv dhe atë: gjuajtje gjysmëautomatike me përsëritje të shkurtër deri në tre plumba njëjt si M16A2 dhe M16A4, ndërsa modeli i ri M – 4, M – 4A1 ka mundësi për gjuajtje automatike në vend me përsëritje të shkurtra me tre plumba si M16A1 dhe M16A3. Pushka automatike M – 4 gjithashtu ka mundësi për vendosjen e hedhësit nën tytën për granatë M203, 40mm. Ajo që e bën këtë pushkë të jetë furnizuese dhe përdorëse për forcat ushtarake është mundësia që në të mund të vendëson elemente shtes si: lloje të ndryshme të shënjestrave, drita taktike etc.

E dizajnuar për lufta ushtarake

1. Pushka automatike M – 4 është e projektuar për shkatrimin forcave të gjalla armiqsore dhe përdorim i lehtë. Nëse është e pajisur me hedhsin e nëntytës, për granata M203 40mm, mund të shfrytëzohet për shkatrimin e bunkerave, ndërtesave si dhe automjetet luftarake të blinduara dhe të pa blinduara.
2. Pushka automatike M – 4 përdor çantë luftarake pre 210 plumbash në 7 karikatorit (kornizë). Mund të përdoret gjat çdo lloj kohe dhe klimatike. E shërben një revole.

Veprim efikas të M – 4:

- Në qëllime të veçanta – 500m
- Në qëllime grupore – 600m

Rezultatet më të mira të M – 4:


- Me një zjarrë të vetëm – 300m
- Me përsëritje të shkurtër – 200m

KARAKTERISTIKAT TAKTIKE DHE TEKNIKE të pushkës automatike M4

Pushka automatike M4	
Prodhues	SHBA „Colt defense”
Model	M4
Kalibri	5.56x45 mm
Sistemi i mbylljes	Mbështjellësi rrotullues
Parimi i punës	Huamarja e gazrave të barutit
Kapaciteti i karikatorit (kornizë)	20 dhe 30 plumba
Bishti me 4 katër pozicione	Mbledhur, ½ hapur, ¾ hapur dhe koplet hapur
Tyta	Me vjaska në anën e djathtë me 6 gjashtë vjaska
Shpejtësia fillestare e kokrëz	880 m/s
Shpejtësia e gjuajtjes	700 – 950 plumba/minut
Largësia maksimale efektive	3600 m
Gjatësia	838 mm
Gjatësia	757 mm
Gjatësia e tytës	368 mm
Masa me karikatorit (kornizë) të zbrazët	2.8 kg
Masa me karikatorit (kornizë) të mbushur	3.2 kg
Masa e karikatorit (kornizë) të zbrazët	0.11 kg

Përshkrim i pjesëve kryesore të pushkës automatike M – 4:

1. Tyta me pjesën e epërme të arkivolit
2. Arkivoli me dorëzën për mbajtje
3. Shtresa
4. Dorëza për mbushje
5. Bartësi i mbështjellësit
6. Mbështjellësi
7. Gjilpëra e goditjes
8. Mekanizmi për tërheqjen e këmbëzës
9. Spiralja kthyese
10. Shënjestra
11. Bishti teleskopik
12. Karikaor (kornizë)
13. Kaish



Pushkomitrolez 7.62mm M – 72



Është e projektuar për tipare luftarake për PM 7.62mm M – 72

Pushkomitrolezi PM 7.62mm M – 76 është pushkë automatike e cila shërben për neutralizimin dhe shkatërimin e forcave të gjalla si dhe pajisje të zjartë për armikun në lagrësi prej 800m. rezultate më të mira janë aritur në distance prej 600m. Efekt i sukseshëm ka në lartësi të vogla për fluturimin e aeroplanëve, helikopterave dhe paragvajt është deri në 500m. shënjestra nga +PM mund të jet një gjuajtje, përsëritëse (përsëritës të shkurtër deri në 5, ndërsa përsëritës të gjatë deri në 15 plumba) dhe pandërprerë.

PM mbushet me karikatorit (kornizë) prej 30 plumba, baraban prej 75 plumba. Shpejtësia luftarake e gjuajtjes është deri në 120 plumba, ndërsa në teori është rreth 600 plumba në minut.

PM 7.62mm M – 72 është e ndrëtuar prej pjesëve:

1. Tyta
2. Shënjestra
3. Komorat e gazit me rregullator të gazrave
4. Cilindri i gazit me shtresë prej druri
5. Mekanizmi kthyes
6. Bartësi i mbështjellësit me piston
7. Mbështjellësi
8. Mbulesa e arkivolit
9. Arkivoli me dorëzën për mbajtje
10. Mekanizmi për tërheqjen e këmbëzës

11. Bishti

12. Këmbët metalike

13. Karikator (kornizë)

14. Pajisjet



KARAKTERISTIKAT TAKTIKE DHE TEKNIKE për PM 7.62mm M – 72

PM 7.62mm M – 72	
Modeli	M – 72
Kalibri	7.62x39 mm
Masa e PM pa karikatorit (kornizë)	3.7 kg
Masa e plot karikatorit (kornizë) me 30 plumba	850 g
Masa e zbrazët e karikatorit (kornizë) për 30 plumba	360 g
Gjatësia e PM me mbajtës druri	1125 mm
Gjatësia e shënjestrës	395 mm
Masa e plumbit boev M67	17 g
Masa e kokrës së plumbit boev M67	8 g
Shpejtësia teorike e gjuajtjes	600 plumba
Shpejtësia e gjuajtjes gjat luftimit	120 plumba në minut
Shpejtësia e gjuajtjes me TKM	3 – 4 tkm/minut
Largësia maksimale e kokrës M67 7.62mm (30 ⁰)	2300 m
Shpejtësia fillestare e kokrës M67 7.62mm	748 m/s
Masam e RAP me 4 karikatorit (kornizë) të mbushur	4415 g
Baraban	75 plumba
Kompleti kryesor luftarak	600 plumba

Pushkomitrolez 7.62mm MG – 3




Është e projektuar për tipare luftarake pushkomitrolez 7.62mm MG – 3

Pushkomitrolezi 7.62mm MG – 3 është armë e ecjes këmbësore është e projektuar për shkatërimin e forcave armoqësore të gjalla, në mënyrë grupore ose veçmas në largesse deri 800m. rezultate më të mira janë aritur me hapjen e zjarrit të habitshëm deri në 500m dhe përsëritje të shkurtra deri 600m, ndërsa gjuajtja e qëllimeve në ajër deri në 500m.

Shënjestra maksimale e kokrëz është 5000m, ndërsa largësia e shënjestrës është deri në 2000m. zjarri na pushkomitrolezi mund të jet përsëritës (përsëritje të shkurtër 5 – 10, përsëritës të gjatë 15 – 20) dhe pandërprerë (deri në 150 plumbga nga një tytë). Shpejtësia teorike e gjuajtjes së pushkomitrolezit është 13 – 17 plumba në second, (800 – 1050 plumba në minute), ndërsa shpejtësia luftarake e gjuajtjes është 300 – 400 plumba në minute. Për gjuajtje nga pushkomitrolezi përdoren plumba 7.62mm, dhe mbushet me rradhitës deri në 50 plumba.

Pjesët kryesore të pushkomitrolezit 7.62mm MG – 3 janë:

1. Tyta me bllokim
2. Arkivoli me bylyzyk të mbuluar
3. Mbulesa e zjarrit me përforcuesin të tërheqjes
4. Shënjestrat e përparme, mbrapsht dhe kundër aeroplaneve
5. Mbulesa e arkivolit
6. Mbështjellësi me dorësën për gacje
7. Shtresa goditëse – kthyese
8. Dorëza me mekanizmin për tërheqjen e këmbëzës dhe siguresa
9. Bishti me bartësin
10. Këmbët metalike



KARAKTERISTIKAT TAKTIKE DHE TEKNIKE për PM 7.62mm MG – 3

PM 7.62 mm MG – 3	
Kalibri i tytës	7.62 mm
Numri i ..	4
Masa e pushkomitrolezit	11 kg
Masa e tytës	3 kg
Gjatësia e armës	121 cm
Gjatësia e tytës	56 cm
Shpejtësia fillestare e kokrëz	715 m/s
Gjatësia e shënjestërs	43 cm
Masa e RAP	3 kg

Mitrolez 7.62 mm M – 84



Është e projektuar për tipare luftarake të mitrolezit 7.62 mm M – 84

Mitrolezi 7.62mm M – 84 është e projektuar për neutralizimin dhe shkatërimin e qëllimeve të grupeve të zbuluar dhe të maskuar, për neutralizimin e paisjeve të zjarta të armikut të cilët veprojnë nga bunkerat dhe ndërtesat, për të shkatëruar dhe pamundësuar lëvizjen e automjeteve të blinduara dhe motorike, shkatërimin e qëllimeve në sipërfaqen ajrore.

Paketa e mitrolezit 7.62 mm M – 84, përbëhet nga:

- Arma
- Pajisje për vendosje
- Pajisje tjera

Rezultate më të mira për gjat gjuajtjes e forcave të gjalla dhe qëllimeve në ajër arrijnë largësi deri në 1000m. rezultate më të mira me një zjarrë të papritur janë aritë në largësi deri në 600m. Me një armë kundra zjarrit njësia mund të shkatërrojë forcën e gjallë dhe zjarrin në një distancë deri në 1500m.

Gjuajtja nga mitrolezi mund të jetë përsëritës (përsëritje të shkurtës deri në 10 plumba, përsëritje të gjatë 11 – 25 plumba) dhe pandërprerë deri në 250 plumba. Gjatësia e shënjestrës është deri në 1500m. Për nevoj mitrolezi shfrytëzon edhe shënjestër passive 5x80 me të cilën shënjestra arinë largësi prej 500 metra. Shpejtësia luftarake gjat gjuajtjes arinë rreth 250 plumba, në teori nga 650 deri 700 plumba në minute. Shpejtësia fillestare e kokrëz është 825 m/s. Largësia maksimale efektive e kokrëz është 3800 metro. Këndi i cili është i vendosur në veprim horizontal me token është vendosur në kufi pre 70^0 , ndërsa për qëllime ajrore është 360^0 .

Për gjuajtjen me mitrolez përdoren plumba luftarake të thjeshtë (kokër çeliku), të rënda (kokër plumbi), të shënuara, depërtim i zjartë, kokëra depërtuese e zjart të shënuar. Mitrolezi mbushet me rradhitës prej 50 plumbave nga paketa e municionit.

Mitrolezin e shërbejnë te shërbyes. Transportohet me mjete motorike dhe me bagëti, në luftë e bartë shërbyesin. Mitrolezi 7.62mm M – 84 i ka pjesët kryesore në vijim:

1. Tyta
2. Arkivoli me dorëzën për mbajtje
3. Mbulesa e arkivolit
4. Shënjestra
5. Komora e gazit me regulator të gazrave
6. Cilindri i gazit
7. Shtresa kthyese

8. Bartësi i mbështjellësit me piston
9. Mbështjellësi
10. Mekanizmi për tërheqjen e këmbëzës
11. Bishti
12. Këmbët metalike
13. Paketat e municionit
14. Rradhitësi
15. Mbushësi i rradhitësit
16. Pajisje për vendosje



KARAKTERISTIKAT TAKTIKE DHE TEKNIKE për mitrolezim 7.62mm M – 84

Mitrolez 7.62mm M – 84	
Masa e mitrolezit me bazament	15 kg
Masa e tytës	2.6 kg
Masa e rradhitësit prej 100 plumba	3.8 kg
Masa e rradhitësit prej 250 plumba	9.4 kg
Masa e bazamentit	5 kg
Gjatësia e mitrolezit	1175 cm
Gjatësia e shënjestrës	663 mm
Shpejtësia fillestare e kokrëz	825 m/s
Shpejtësia teorike e gjuajtjes	700 plumba/minut
Shpejtësia luftarake e gjuajtjes	250 plumba/minut
Largësia maksimale efektive	3800m

Armët punëdore

Si armë për mbytjen e bagëtis përdoren kryesisht pistoletat e konstruara enkas për këtë qëllim. Armët punëdore janë ato armë të cilat për nga pamja e jashtme dhe mënyra e përdorimit dallohen nga armët e fabrikuara. Si rregull nuk ekzistojn dy arma të tilla me karakteristika të njejta balistike. Kalibri i këtyre armëve është gati i pamatshëm, poektilet janë të ndryshëm dhe janë të punuar në mënyrë primitive. Tytën nuk e kanë me lugosje. Predhat janë gjithashtu artizanale, në të shumtën e rasteve të krijuara nga pjesët e predhës së armës së fabrikuar. Për mbushje barutore përdoren lloje të ndryshme të barutit, madje edhe baruti i gjyleve në shufra. Sasia e barutit vendoset në bazë të vlersimit të lire, ndërsa predhat të cilat përdoren për të njejtat armë dallohen njëra nga tjetra. Te ky lloji i armëve të zjarrit dallohen karakteristikat e posaçme dhe vështirë mund të bëhet klasifikimi si dhe të përcaktohet se cili lloji të armës i përkasin. Përveç mbushjes me barut dhe tytës nga të cilat hidhet proektili, të gjithë karakteristikat e tjera

duke filluar prej mënyrës së ndezjes, vënies në shenjë, veprimit të proektilit në pëngesë, largësisë që mund të arrijë, në masë të konsiderueshme dallohet nga armët klasike të fabrikuara.



Armët e riparuar

Armët e riparuar (armët e shkurtra) në balistikën kriminalistike përfshinë të gjitha llojet e pushkëve të fabrikuara të cilave më vonë u shkurtohet tyta e tyre origjinale. Zakonisht shkurtimi i tytës bëhet në mënyrë të vrazhdë, ashtu që në vendin e prerjes vërehen qartë gjurmët e shkurtimit. Prerja e tytës së karabinave ushtarake bëhet jashtë ndonjë kriteri të caktuar, zakonisht me anë të sharrës për shufra „bonsekut”. Tyta shkurtohet deri në atë masë, e cila i përgjigjet dedikimit apo që të mund të futet nën pallto apo nën këmbëzën e pantollonave, me qëllim që të mos zgjojnë kureshtjen e njerzve të tjerë. Për këto qëllime shpesh bëhet prerja e bishtit „ kondakut” të drujntë deri te qafa e tijë ashtuqë arma e shkurtër mer pamjen e „kobures”.



Armat e fshehura i taokjnë të kaluarës. Në të shumtën e rasteve kemi të bëjmë me pushkë të fshehura në shkop, e cila mund të ndezë vetëm një fishek. Kryesi, i cili do të paraqitet haptas me pushkën e fshehur në shkop me vetë faktin se mbanë shkopin do të tërhiqet vëmendja. Megjithatë idetë mbi armët e fshehura nuk janë braktisur në qarqet kriminale dhe kanë fituar forma të reja të zgjedhjes. Gati në tërë Evropën janë shënuar raste të përdorimit të armës së fshehur në laps ose në sende të ngjajshme që gjenë përdorim në jetën e përditshme.



Sh. Arma laps. Shkop, fig.

Armët me silenciator (zhurmëshues)

Armët zhurmëshuese (me silenciator) janë ato armë të cilat përmbajnë mbulesë të posaçme gome në formë tyte, e cila vendoset në majë të tytës, qëllimi i së cilës është pengimi i zhurmës, e cila e shoqëron ndezjen e fishekut. Zhurmëshuesit janë pajisje që vendosen mbi fundin e tytës së armës. „zhurma’’ e armës së krijuar në momentin e qitjes përbëhet nga një sërë zhurmash që krijohen nga: lëvizja e pjesëve mekanike të armës; gazrat e „shpërthimit’’; lëvizja e predhës në ajër. Zhurmëshuesit më shpesh i vihet armës së shkurtër, por ekzistojnë edhe të tillë të dedikuara për arma të gjata.

